

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË AUTORITETIN E AVIACIONIT CIVIL TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Autoritetin e Aviacionit Civil, Tiranë, me objekt “Mbi zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë së veprimtarisë ekonomiko-financiare” për periudhën 01.03.2012 deri më 31.12.2013, dhe masat për përmirësimin e gjendjes janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 32 datë 31.03.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 1173/9 datë 31.03.2014, dërguar Z. Edmond Haxhinasto, Ministër i Transportit dhe Infrastrukturës, shkresën nr. 1173/7 datë 31.03.2014, dërguar Z. Petrit Sulaj, Drejtor Ekzekutiv i AAC, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Këshilli Drejtues dhe Drejtori Ekzekutiv, të marri masa për zbatimin e rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm i KLSH, për arsye se asnjë nga masat e zhdëmtimit të rekomanduara, në shumën gjithsej 8,586,666 lekë, nuk janë zbatuar.

Menjëherë

2. Këshilli Drejtues, të marri masa që në të ardhmen mos të nxjerrë vendime të cilat janë në kundërshtim me ligjin për AAC, për tejkalimin e strukturës organike, veprim i cili ka ndodhur në vitin 2013.

Menjëherë

3. Këshilli Drejtues, të marri masa që në të ardhmen të mos miratojë sponsorizime nga fondet e AAC, të cilat nuk janë në përputhje me ligjin për sponsorizimet, si në rastin e vendimit nr. 32, datë 30.05.2013.

Menjëherë

4. Këshilli Drejtues, Drejtori Ekzekutiv dhe drejtorët e drejtorive, të marrin masa për të kryer një studim të plotë për përcaktimin e tarifave për shërbimet që ofron AAC dhe në veçanti për tarifën e sigurisë në fluturim, duke u bazuar në kostot reale, për arsye se për këtë shërbim nuk është përcaktuar tarifë, veprim ky në kundërshtim me nenin 9, pika 2 e ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror në RSH”, dhe nenin 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 i ndryshuar.

Menjëherë

5. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marri masa që në të ardhmen të plotësojë me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm programin e zhvillimit ekonomiko-financiar, duke filluar që nga propozimet e drejtorëve, Drejtorit Ekzekutiv, Këshillit Drejtues deri te miratimi nga Ministri i Transportit dhe infrastrukturës. E njëjta praktikë të ndiqet edhe për raste kur ka ndryshim gjatë vitit të programit të zhvillimit.

Menjëherë

6. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marri masa që në të ardhmen gjatë fazës së hartimit dhe miratimit të programit të zhvillimit ekonomik-financiar, të identifikojë dhe planifikojë në mënyrë sa më reale dhe të saktë llojin e nevojës dhe fondin e përcaktuar për tu investuar.

Menjëherë

7. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marri masa që në të ardhmen në lidhje me mënyrën e raportimit për realizimin e programit të zhvillimit, të zbatojë detyrimet e përcaktuara në ligjin për AAC, për arsye se për periudhën e audituar vitet 2012-2013, rezultoi se mënyra e raportimit nuk ka qenë në përputhje me ligjin.

Menjëherë

8. Autoriteti i Aviacionit Civil, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës dhe Ministria e Financave, të marrin masa për të ndryshuar udhëzimin e përbashkët nr.5, datë 17.04.2007 “Për përdorimin e fondeve të investimeve buxhetore për konservimin e Aeroportit të Kukësit”, për arsye se në udhëzim është përcaktuar se shpenzimet për aeroportin e Kukësit përballohen nga buxheti i shtetit, ndërsa në fakt shpenzimet për konservimin e këtij aeroporti janë përballuar nga AAC. Në hartimin dhe miratimin e udhëzimit të ri, të përcaktohet qartë se cilat shpenzime për aeroportin e Kukësit duhet të përballohen nga AAC dhe cilat nga Buxheti i Shtetit.

Menjëherë

9. Drejtorja e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, Drejtori Ekzekutiv, Këshilli Drejtues, të marrin masa për të bërë rakordimet për tepricën e të ardhurave të mbartura nga viti në vit dhe të pa derdhura në buxhetin e shtetit, në përputhje me ligjin për AAC të ndryshuar.

Menjëherë

10. Drejtori Ekzekutiv, Këshilli Drejtues të marrin masa për të propozuar dhe miratuar, riaplikimin e tarifës për leje fluturimi turistik Charter, tarifë e cila është hequr pa dhënë asnjë sqarim apo argumentim, në kundërshtim me nenin 9, pika 2 e ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodi Ajror në RSH”, dhe nenin 17 të ligjit nr. 10233, datë 11.2.2010 i ndryshuar dhe si pasojë është shkaktuar një efekt negativ në shumën 239,790 Euro.

Menjëherë

11. Drejtori Ekzekutiv të marri masa për të bërë rakordimin e plotë për pagesat e arkëtuara nga operatorët e fluturimit edhe për periudhën para vitit 2012, me qëllim për të evidentuar diferencat e pa arkëtuara, si dhe për të nxjerrë përgjegjësitë e personave të cilët kanë qenë të ngarkuar me licencimin, arkëtimin, mbajtjen e evidencave etj., për shërbimet e ofruara nga Autoriteti.

Menjëherë

12. Drejtori Ekzekutiv dhe drejtorët e drejtorive të marrin masa që në të ardhmen të kryejnë rakordime të rregullta e periodike, në lidhje me numrin e licencave të lëshuara dhe shumave të arkëtuara nga operatorët ekonomik. Në raportet periodike për punën e secilës drejtori të evidentohen rastet e mos përmbushjes së kërkesave dhe mos arkëtimin të detyrimeve nga operatorët e fluturimit dhe nga operatorët e tjerë.

Menjëherë

13. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masa për të përdorur në mënyrë të drejtë mjetet monetare të entit për të planifikuar blerjet e mallrave të domosdoshëm për kryerjen e aktivitetit të entit, për të mos lejuar që të rinë gjendje në magazinë të materialeve të përdorura.

Menjëherë

14. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Këshilli Drejtues i AAC, të marrin masa për bërë rishpërndarjen e fitimit të realizuar dhe të trashëguar nga aktiviteti i AAC për vitet 2010-2012, në shumën 88,234,557 lekë, duke bërë reflektime përkatëse në nivelin e tarifave, si dhe të derdhë në buxhet e shtetit shuma 56,511,628 lekë, si të ardhura të realizuara por të papërdorura deri në periudhën objekt auditimi.

Menjëherë

15. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa në bashkëpunim me drejtoritë që ofrojnë shërbimet përkatëse në AAC, përkatësisht Drejtoria e Zhvillimit të Trafikut Ajror dhe Drejtoria e Sigurisë Ajrore, për të bërë rakordimin e të ardhurave të arkëtuara në bankë në shumën 247,335,044 lekë, të realizuara nga tarifat administrative dhe rregullatorë për operatorë të ndryshëm.

Menjëherë

16. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të likuiduar në kohë detyrimet e prapambetura ndaj klientëve në shumën 9,567,150 lekë, duke përdorur likuiditete të lira të cilat mbahen gjendje në llogaritë bankare të Autoritetit.

Menjëherë

17. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të përgatitur manualin operacional për kryerjen e proceseve të punës të ngarkuara për këtë drejtori, mbi organizimin dhe procedurat kontabël, për ndarjen e detyrave me shkrim në sektorin e financës, i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit, për marrjen e detyrimeve dhe përgjegjësi në punë.

Menjëherë

18. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të kuadruar të dhënat financiare midis dy periudhave ushtrimore, që kanë gjeneruar nga programi Alfa i kontabilitetit në çeljen e llogarive për aktive e qëndrueshme në fillim të vitit 2013, me gjëndjen e llogarive në fund të vitit 2012, për aktivet afatgjata të trupëzuara në vlerën minus 423,280 lekë, dhe në aktivet afatgjata të trupëzuara në shumën plus 2,111,602 lekë.

Menjëherë

19. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të përgatitur një rregullore të miratuar nga Këshilli Drejtues, për të unifikuar procedurat për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë shtetit, në mënyrë që prenotimi i biletave në agjencitë e udhëtimit dhe rimbursimi i pagesave për biletat e avionit të bëhet me procedurë nga AAC.

Menjëherë

20. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të parashikuar fondet në regjistrin e realizimit të prokurimeve publike, sipas natyrës, sasisë dhe llojet e artikujve që do të prokurohen dhe të bëjë përlllogaritjet sipas grup mallrash apo shërbimesh të ngjashme, në përputhje me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar “Kreu VI, pika 2/a.

Menjëherë

21. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që komisioni i prokurimeve për blerje të vogla i ngritur pranë AAC, të kryejë procedurat e plota për prokurimit me blerje të vogla, bazuar në udhërin e prokurimit të nxjerrë nga titullari i entit.

Menjëherë

22. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa që sektori i financës të kryejë pagesat për blerjet me prokurime të vogla bazuar në urdhër prokurimet e nxjerra nga titullari ekzekutiv i entit, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës.

Menjëherë

23. Drejtoria e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, të marrë masa për të kryer procesin e inventarizimit të aktive dhe inventarit ekonomik të AAC, brenda afateve ligjore duke përcaktuar afatet dhe ndarjen e detyrave dhe përgjegjësive për çdo anëtarë të komisionit, sipas kartelave e llogarive të aktiveve të përgatitura nga specialistja e financës, dhe të pasqyrojnë në kontabilitet rezultatet e inventarit bazuar në raportin përfundimtar të përgatitur pas numërimit fizik të materialeve. Gjithashtu, të reflektohen daljet jashtë përdorimit të materialeve të dëmtuara, duke kuadruar gjendjen fizike të tyre me vlerat kontabël, në përputhje me ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”.

Menjëherë

24. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues të marrin masa që në kontratat individuale të punës të përcaktojnë edhe masa të tjera disiplinore, përveç masës së zgjidhjes së kontratës.

Menjëherë

25. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues të marrin masa për hartimin dhe miratimin e rregullores së re të AAC, në të cilën të përcaktohen qartë dhe saktë përgjegjësitë, detyrat dhe të drejtat për çdo post pune duke filluar nga zv/drejtorë ekzekutiv deri te punonjësi i nivelit më të ulët, për arsye se në rregulloren aktuale këto detyra e të drejta janë përcaktuar në përgjithësi.

Menjëherë

26. Drejtori Ekzekutiv të marrin masa në të ardhmen për rekrutimin e punonjëseve të rinj, të zbatojë me përpikmëri rregulloren e rekrutimit të miratuar me vendim të KD. Gjithashtu, të marrin masa për të pasqyruar ndryshimet strukturore në organikën e AAC edhe në rregulloren e brendshme, në mënyrë që mos të ketë konfuzion dhe mungesë kompetencash në ushtrimin e detyrave funksionale.

Menjëherë

27. Drejtori Ekzekutiv, Këshilli Drejtues, të marrë masa për punonjësit që kanë vjetërsi pune në AAC, të cilët figurojnë punonjës para vitit 2011, të plotësojnë kriteret specifike të marrjes ose të krijojnë sigurinë e duhur juridike për mos cenim të vendit të punës, për arsye se kriteret aktuale të rekrutimit të punonjësve në punë janë të përcaktuara në rregulloren e rekrutimit të miratuar me vendimin nr. 10, datë 24.10.2011.

Menjëherë

28. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues të marrin masa për të plotësuar dosjet e shtatë punonjësve, të cilat janë konstatuar me mangësi, si dhe për të gjitha dosjet e tjera që kanë probleme të ngjashme.

Menjëherë

29. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues të marrin masa që në të ardhmen të mos marrin vendime për të dërguar në trajnime jashtë vendit, punonjës të cilët nuk u përputhet vendi i punës me llojin e trajnimit, për arsye se gjatë vitit 2013, është konstatuar një rast i tillë, i cili është në kundërshtim me rregulloren e brendshme.

Menjëherë

30. Drejtori Ekzekutiv të marri masa që në të ardhmen vendimmarrja për largimin nga puna të punonjësve, të jetë e argumentuar dhe e mbështetur ligjërisht, me qëllim që edhe në rast ankimit në gjykatë, vendimi të mos jetë i kontestuar dhe personat të përfitojnë dëmshpërblime, për arsye se, për periudhën objekt auditimi në 3 raste shuma e dëmshpërblimit është 3,870,870 lekë, shumë e cila ka sjellë efekt negativ.

Menjëherë

31. Drejtori Ekzekutiv të marri masa që në të ardhmen për rastet e çështjeve gjyqësore, AAC të përfaqësohet nga specialistët përkatës së sektorit të përfaqësimit ligjor, për arsye se gjatë periudhës objekt auditimi, AAC në disa raste nuk është përfaqësuar nga këta specialistë.

Menjëherë

32. Drejtori Ekzekutiv dhe Këshilli Drejtues të marrin masa, që gjatë vitit 2014, të përgatisin dhe propozojnë për miratim në Këshillin e Ministrave, një studim për rritjen e pagave të punonjësve, për arsye se në ligjin e AAC, i ndryshuar, në nenin 17, pika 4, përcaktohet se të ardhurat përdoren për paga, sigurime, shpërblime etj., gjithashtu të ardhurat e Autoritetit janë të konsiderueshme, si dhe rritja e pagave të punonjësve është kërkesë e organizatave ndërkombëtare që monitorojnë punë e AAC dhe ku Autoriteti aderon.

Menjëherë

33. Drejtori Ekzekutiv të marri masa për të ndryshuar strukturën e Drejtorisë Drejtorisë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, me qëllim ndarjen e Sektorit të Prokurimeve dhe Përfaqësimit Ligjor, duke mos qenë në vartësi të kësaj drejtorie, për arsye se NJP, në përputhje me ligjin “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM për rregullat e prokurimit publik, e ndryshuar, nuk mund të jetë pjesë e Drejtorisë së Financës, për faktin se specialistët e kësaj

drejtorie janë edhe përgjegjësit për likuidimin, zbatimin e kontratave të lidhura nga procedura e tenderimit dhe blerjeve me vlera të vogla.

Menjëherë

34. Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masa për të ngritur një Njësi Prokurimi, e cila duhet të administrojë, në mënyrë të vazhdueshme, procesin e prokurimit. Njësia e prokurimit duhet të përbëhet të paktën nga 3 persona me arsim të lartë, ku njëri prej tyre duhet të jetë jurist, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

35. Njësia e Prokurimit, të marrë masa për të plotësuar mangësitë e konstatuara në dosjet e prokurimit sipas legjislacionit përkatës duke u bazuar në azhornimet e vazhdueshme të ligjit për prokurimin publik dhe në rregullat për prokurimin publik, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

36. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masa që të trajnojë anëtarët e njësive të prokurimit të paktën njëherë në vit, për çështjet e prokurimit publik, për arsye se APP-ja duhet të mbikëqyrë krijimin e njësive të prokurimit të AAC-së, dhe trajnimin e personelit, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

Menjëherë

37. Autoriteti i Aviacionit Civil të marrë masa që të hartojë dhe të miratojë në organet kompetente strategjinë e zhvillimit të Aviacionit Civil.

Menjëherë

38. Autoriteti i Aviacionit Civil dhe drejtoritë përkatëse të marrin masa për të hartuar programet e veprimit vjetor, ku të pasqyrohen masat teknike, ekonomike e financiare, si dhe masat për realizimin e këtij programi.

Menjëherë

39. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masa konkrete për monitorimin të programit vjetor, me qëllim vlerësimin e secilës drejtori dhe të çdo punonjësi, sipas arritjeve dhe realizimit të programit.

Menjëherë

40. Drejtori Ekzekutiv (nëpunësi autorizues) dhe drejtorët e drejtorive të marrin masa të menjëhershme për ngritjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në përputhje me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”; udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, me qëllim hartimin e raportit të cilësisë së sistemeve të kontrollit të brendshëm, si dhe të deklaratës përkatëse.

Menjëherë

41. Autoriteti i Aviacionit Civil, të marrë masat e nevojshme që proceset gjyqësore të cilta kanë të bëjnë me detyrimet e tretëve ndaj këtij Autoriteti, të ndiqen deri në shkallën më të lartë të gjykimit.

Menjëherë

B. MASA ZHDËMTIMI

1. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës gjithsej **544,000 lekë**, të shkaktuar nga personat të larguar nga puna, por që nuk kanë dorëzuar materialet në ngarkim të tyre, duke nxjerrë urdhër zhdëmtimet përkatësisht;

-Për z. [REDAKTUAR] në shumën 256,000 lekë;

-Për z. [REDAKTUAR] në shumën 144,000 lekë;

-Për z. [REDAKTUAR] në shumën 144,000 lekë.

2. Të kërkohet në rrugë ligjore, si dhe të ndiqen të gjitha shkallët e gjykimit nga Autoriteti i Aviacionit Civil në bashkëpunim me Avokatin e Shtetit, për shpërblimin e dëmit me vlerë **299,600 lekë**, në masën e sigurimit të ofertës të operatorit ekonomik [REDAKTUAR] për tërheqje të njëanshme nga procedura e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së”, në zbatim të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

3. Të kërkohet në rrugë ligjore, duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe shkallët e gjykimit, arkëtimi i shumës gjithsej **8,152,500 lekë**, nga operatori [REDAKTUAR], i cili e ka përfituar këtë shumë padrejtësisht, në kundërshtim me nenin 15, germa “a” të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodit Ajrur në RSH”, me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” dhe me rregulloren e brendshme të AAC.

C. MASA DISIPLINORE

I. Mbështetur në Nenin 35, pika 1 germa “e”, të rregullores së brendshme të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 23.04.2013, kërkohet nga Drejtori Ekzekutiv të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Largim nga puna në Autoritet”

1. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjëse sektori të planifikimit financiar, statistikave, tarifave dhe buxhetit, për arsye se:

- Për vitin 2012 nuk ka kryer me ANTA SHA, rakordimet për tarifën e sigurisë, e cila arkëtohet nëpërmjet ANTA SHA, për arsye se kjo tarifë vilet në total nga Eurokontrolli për llogari të ANTA, ku kjo e fundit derdh në llogaritë e AAC, pjesën që i përket Autoritetit;
- Për përdorim të tepriçës së të ardhurave të vitit 2012, shumë e cila përdoret vetëm për mbulimin e shpenzimeve të angazhimit, në cilat përfshihen detyrimet për kontrata shërbime, mallra etj., të cilat kanë një afat kohor më shumë se një vit.
- Për pjesën e akumuluar të të ardhurave të krijuar në vite, nuk ka paraqitur një realcion dhe propozim për t'u derdhur në llogaritë e buxhetit të shtetit, në përputhje me ligjin e AAC.
- Nuk ju paraqit grupit të auditimit, ndonse u kërkuan disa detajime të sakta dhe të plota, për pagesat e kryera me fondet e të ardhurave të akumuluar në vite.
- Për planifikim jo të saktë dhe me rezerva të plan buxhetit për periudhën e auditimit.
- Për mos hartimin e relacioneve shpjeguese mbi planifikimin dhe realizimin e plan buxhetit, në veçanti për realizimin dhe mosrealizim e investimeve për 9-mujorin e vitit 2013, ku raportimi është vetëm në formë tabelare. Nuk ka një analizë dhe argumentim të ecurisë së realizimit të programit ekonomikë.
- Nuk ka kryer rakordimet me drejtoritë e tjera për të ardhurat e vjela nga tarifatat për shërbimet që ofron AAC, ku për periudhë objekt auditimi rezulton se shoqëria ■■■ nuk ka arkëtuar detyrimet në shumën **8,152,500 lekë**, nga të cilët 4,285,000 lekë për vitin 2012 dhe 3,867,500 lekë për vitin 2013, mosarkëtimi i kësaj shume ka shkaktuar dëm ekonomik për Autoritetin dhe mosvjelja e tarifave për shërbimin e ofruar nga AAC dhe e përfituar nga kompania ■■■ është veprim në kundërshtim me pikën 2, të nenit 10, të ligjit nr.10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i RSH”, i ndryshuar, pika 1, 2 të nenit 17, dhe nenet 19, 20 të ligjit nr.10 233 datë 11.2.2010 “Për AAC”, ndryshuar me ligji nr. 10479, datë 10.11.2011.
- Nuk ka evidentuar si debitorë shoqërinë ■■■ për vitet e mëprashëm, vite në të cilat kjo shoqëri figuron me detyrime të prapambetura, si dhe këto detyrime nuk janë rregjistruar në llogaritë e autoritetit.
- Nuk ka përmbushur parimin e bashkëpunimit i cili duhet të udhëheqë të gjithë administratën e Autoritetit, me qëllim që të sigurojë që puna të kryhet rregullisht, vendimet të merren me kujdes dhe të zbatohen me përpikëmeri, në përputhje me rregulloren e brendshme.
- Gjatë vitit 2012, ka lejuar të bëhen pagesa për blerje të mallrave të panevojshme, për arsyes se rezultojnë gjendje në magazinë në shumën 1,716,592 lekë, nuk janë përdorur duke bllokuar padrejtësisht fondet e lira të AAC;
- Nuk ka pasqyruar në kontabilitet veprimet financiare në lidhje me; rishpërndarjen e fitimit, të realizuar dhe të trashëguar nga aktiviteti i AAC për vitet 2010, 2011 dhe 2012, në shumën 88,234,557 lekë, përkatësisht në shumën 19,253,833 lekë, në vitin 2010, në shumën 37,257,795 lekë në vitin 2011, dhe në shumën 31,722,929 lekë në vitin 2012;
- Nuk ka bërë reflektime në nivelin e tarifave dhe nuk ka bërë derdhjet në buxhet për të ardhurat e realizuara e të papërdorura deri në periudhën objekt auditimi në shumën 56,511,628 lekë;
- Nuk ka informuar Këshillin Drejtues të AAC, për gjëndjen e llogarisë fitime të entit sipas bilancit kontabël; Nuk ka kërkuar të marren vendime nga KD i entit për të bërë rishpërndarjen e fitimit të realizuar dhe të trashëguar nga periudhat e mëparshme;
- Për vitin 2013, nuk ka bërë rakordimin me drejtoritë që ofrojnë shërbimet përkatëse në AAC, përkatësisht ■■■ .■■■ dhe ■■■ për të ardhurat të arkëtuara në bankë në shumën 247,335,044 lekë, të realizuara nga tarifatat administrative dhe rregullatorë për operatorë të ndryshëm, të pasqyruara si të ardhura në pasqyrat e bilancit kontabël të vitit ushtrimor janar dhjetor 2013.

- nuk ka menaxhuar drejt mjetet monetare të lira të entit, për të shlyer detyrimet të papaguara ndaj klientëve të ndryshëm në 9,567,150 lekë, që rezultojnë gjëndje në bilancin kontabël të vitit 2012, me gjithë AAC ka patur gjëndje në llogarinë bankare në 31.12.2012 të entit në shumën 63,126,444 lekë shumë kjo sipas ekstratove të bankave;

-Nuk ka përgatitur një manual operacional për kryerjen e proceseve të ngarkuara për këtë drejtori, për ndarjen e detyrave me shkrim në sektorin e financës,si dhe nuk ka një dokument ku të përshkruajnë organizimin dhe procedurat kontabël, i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit, për marrjen e detyrimeve dhe përgjegjësi në punë;

-Në bilancin kontabël të vitit ushtrimor 2013, nuk përputhet çelja e llogarive për aktivet e qëndrueshme në fillim të vitit 2013 (që kanë gjeneruar nga programi Alfa i kontabilitetit), me gjëndjen e llogarive në fund të vitit 2012 (sipas raportit të ekspertit kontabël për bilancin e vitit 2012), përkatësisht; për aktivet afatgjata të patrupëzuara në vlerën - 423,280 lekë, dhe në aktivet afatgjata të trupëzuara në shumën +2,111,602 lekë. Moskuadrimi i të dhënave midis dy periudhave ushtrimore, bie ndesh me nenin 11, pika 1 dhe 2 “Krahasueshmëria”, të ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004, “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar.

-Nuk ka marrë masa për të përcaktuar një procedurë të unifikuar ose një rregullore të miratuar nga Këshilli Drejtues, për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë shtetit, në mënyrë që rimbursimi i pagesave për biletat e avionit të mos vazhdojë të bëhet me me cek në dorë lëshuar në emër të punonjësve, të cilët kanë prenotuar dhe blerë vetë biletat në agjencitë të ndryshme të udhëtimit, por të kryhet me procedurë nga AAC.

-Nuk ka bërë të mundur arkëtimin nga shoqëria ██████ shpk, detyrimet në shumën **8,152,500 lekë**, nga të cilët 4,285,000 lekë për vitin 2012 dhe 3,867,500 lekë për vitin 2013. Mosarkëtimi i kësaj shume ka shkaktuar dëm ekonomik për Autoritetin dhe mosvjellja e tarifave për shërbimin e ofruar nga AAC dhe e përfituar nga kompania ██████ janë veprim në kundërshtim me pikën 2, të nenit 10, të ligjit nr.10040, datë 22.12.2008 “Kodi ajror i RSH”, i ndryshuar, pika 1, 2 të nenit 17, nenet 19, 20 të ligjit nr.10 233 datë 11.2.2010 “Për AAC”, ndryshuar me ligji nr. 10479, datë 10.11.2011. Midis drejtorive të Sigurisë Ajrore, të Zhvillimit të Transportit Ajror dhe Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetës,

-Nuk ka kryer një rakordime për numrin e shërbimeve të orfuara dhe shumës së faurave të arkëtuara. Gjithashtu me drejtoritë të cilat janë përgjegjëse për lëshimin e certifikatave dhe lejeve të cilësuar në tabelën bashkëlidhur, nuk ka kryer rakordime

-Nuk ka pasqyruar të ardhurat e arkëtuara për shërbimet e ofruara nga këto drejtoritë e AAC, si dhe nuk është evidentuar shoqëria Belle Air si debitore. Për më tepër kjo shoqëri figuron debitor në fund të vitit 2012 dhe për këtë në raportimin vjetor të realizimit të programit të zhvillimit, nuk është evidentuar ky fakt, nuk janë marrë masa për shlyerjen e detyrimeve të mbartaura.

-Moskoordinimi, mosbashkërendimi, mosraportimi në përputhje me ligjin e AAC, rregulloren e brendshme të AAC, programet e punës së drejtorive, kanë sjell devijime dhe shmangie në arkëtimin e të ardhurave duke bërë favorizimin për operatorin ██████ veprim ky në kundërshtim edhe me nenin 15, germa “a” të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 “Kodit Ajror në RSH”, ku përcaktohet që subjekti që nuk përmbush kërkesat dhe detyrimet, që burojnë nga Kodi ajror dhe akte të tjera të dala në zbatim të tij, licenca e tij, mund të refuzohet, pezullohet etj.

-Nuk ka bërë rakordimin me drejtoritë që ofrojnë shërbimet përkatëse në AAC, përkatësisht ██████ dhe ██████ për të ardhurat të arkëtuara në bankë në shumën 247,335,044 lekë, të realizuara nga

tarifat administrative dhe rregullatore për operatorë të ndryshëm, të pasqyruara si të ardhura në pasqyrat e bilancit kontabël të vitit ushtrimor janar dhjetor 2013.

2. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë përgjegjës sektori në drejtorinë e Zhvillimit të Transportit Ajror.

-Nuk kanë kryer rakordime për numrin e shërbimeve të ofruara dhe shumës së faurave të arkëtuara, për shërbimet e drejtorisë ku ka qenë dhe është përgjegjës sektori.

-Nuk ka kryer raportime në lidhje me punën e sektorit dhe drejtorisë, si dhe në raportimin vjetorë të Autoritetit, paraqitur te Drejtori Ekzekutiv, kaluar te Këshilli Drejtues dhe Ministri.

-Nuk ka pasqyruar të ardhurat e arkëtuara për shërbimet e ofruara nga drejtori ku ka qenë përgjegjës sektori, shumat e pa arkëtuara, si dhe nuk ka marrë masa për evidentimin e shoqërisë [REDAKTUAR] si debitore. Kjo shoqëri figuron debitor në fund të vitit 2012 dhe për këtë në raportimin vjetor të realizimit të programit të zhvillimit, nuk është evidentuar ky fakt, për më tepër kësaj shoqërie i janë ofruar të njëjtat shërbimet edhe për vitin 2013, vit në të cilin kompania ka shtuar detyrimet duke mos kryer pagesa ndonse ka marrë shërbimin e AAC.

-Nuk ka marrë masa për funksionimin e sistemeve të kontroleve të brendshme në drejtorinë ku ka qenë përgjegjës, veprim ky në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin". Moskoordinimi, mosbashkërendimi, mosraportimi në përputhje me ligjin e AAC, rregulloren e brendshme të AAC, programet e punës së drejtorive, kanë sjell devijime dhe shmangie në arkëtimin e të ardhurave duke bërë favorizimin për operatorin Belle Air, veprim ky në kundërshtim edhe me nenin 15, germa "a" të ligjit nr. 10040, datë 22.12.2008 "Kodit Ajror në RSH", ku përcaktohet që subjekti që nuk përmbush kërkesat dhe detyrimet, që burojnë nga Kodi ajror dhe akte të tjera të dala në zbatim të tij, licenca e tij, mund të refuzohet, pezullohet etj

II. Mbështetur në nenin 35, pika 1, germa "d", të rregullores së brendshme të miratuar me vendim të Këshillit Drejtues nr. 29, datë 23.04.2013, kërkojmë nga Drejtori Ekzekutiv të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

"Paralajmërim me shkrim për largim nga puna me afat shlyerje 1 (një) vit".

1. Për z. [REDAKTUAR] me detyrë drejtor i Drejtorisë së financës dhe Shërbimeve

Mbështetëse, për arsye se:

- Gjatë vitit 2012, ka lejuar të bëhen pagesa për blerje të mallrave të panevojshme, për arsyes se rezultojnë gjendje në magazinë në shumën 1,716,592 lekë, nuk janë përdorur duke bllokuar padrejtësisht fondet e lira të AAC;

-Nuk ka pasqyruar në kontabilitet veprimet financiare në lidhje me; rishpërndarjen e fitimit, të realizuar dhe të trashëguar nga aktiviteti i AAC për vitet 2010, 2011 dhe 2012, në shumën 88,234,557 lekë, përkatësisht në shumën 19,253,833 lekë, në vitin 2010, në shumën 37,257,795 lekë në vitin 2011, dhe në shumën 31,722,929 lekë në vitin 2012;

-Nuk ka bërë reflektime në nivelin e tarifave dhe nuk ka bërë derdhjet në buxhet për të ardhurat e realizuara e të papërdorura deri në periudhën objekt auditimi në shumën 56,511,628 lekë;

-Nuk ka informuar Këshillin Drejtues të AAC, për gjendjen e llogarisë fitime të entit sipas bilancit kontabël; Nuk ka kërkuar të marren vendime nga KD i entit për të bërë rishpërndarjen e fitimit të realizuar dhe të trashëguar nga periudhat e mëparshme;

-Nuk ka përgatitur një manual operacional për kryerjen e proceseve të ngarkuara për këtë drejtori, për ndarjen e detyrave me shkrim në sektorin e financës, si dhe nuk ka një dokument ku të përshkruajnë organizimin dhe procedurat kontabël, i nevojshëm për kuptimin e sistemit të trajtimit të informacionit kontabël dhe të kryerjes së auditimit, për marrjen e detyrimeve dhe përgjegjësi në punë;

-Nuk ka marrë masa për të përcaktuar një procedurë të unifikuar ose një rregullore të miratuar nga Këshilli Drejtues, për punonjësit që shkojnë me shërbim jashtë shtetit, në mënyrë që rimbursimi i pagesave për biletat e avionit të mos vazhdojë të bëhet me cek në dorë lëshuar në emër të punonjësve, të cilët kanë prenotuar dhe blerë vetë biletat në agjencitë të ndryshme të udhëtimit, por të kryhet me procedurë nga AAC.

- Për përdorim të tepriçës së të ardhurave të vitit 2012, shumë e cila përdoret vetëm për mbulimin e shpenzimeve të angazhimit, në cilat përfshihen detyrimet për kontrata shërbime, mallra etj., të cilat kanë një afat kohor më shumë se një vit.

-Për pjesën e akumuluar të të ardhurave të krijuar në vite, nuk ka paraqitur një realcion dhe propozim për t'u derdhur në llogaritë e buxhetit të shtetit, në përputhje me ligjin e AAC.

-Për planifikim jo të saktë dhe me rezerva të plan buxhetit për periudhën e auditimit.

-Për mos hartimin e relacioneve shpjeguese mbi planifikimin dhe realizimin e plan buxhetit, në veçanti për realizimin dhe mosrealizim e investimeve për 9-mujorin e vitit 2013, ku raportimi është vetëm në formë tabelare. Nuk ka një analizë dhe argumentim të ecurisë së realizimit të programit ekonomikë.

-Nuk ka evidentuar si debitorë shoqërinë Belle Air për vitet e mëprashëm, vite në të cilat kjo shoqëri figuron me detyrime të prapambetura, si dhe këto detyrime nuk janë regjistruar në llogaritë e autoritetit.

III- Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në procedurat e prokurimit si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar për çdo procedurë zhvilluar në vitet 2010-2012, bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit” i ndryshuar, i rekomandojmë Agjencisë së Prokurimit Publik, që në zbatim të nenit 13 dhe 72 të ligjit nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu X, të japë *masë disiplinore* për:

1. zj. ■■■■ me detyrë Përgjegjëse Sektori në Drejtorinë e Standardizimit Teknik pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtares së njësisë së prokurimit, për arsye se:

-Nuk ka kryer asnjë trajnim në APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika1/b, ku përcaktohet se ata duhet të kryejnë të paktën 1 trajnim në vit për çështjet e prokurimit publik;

-Mungon llogaritja e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në dosjet e tenderave në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar me fond limit 50,000,000 lekë, mungojnë gjurmët e argumentimit të fondit limit dhe arsyetimi tek procesverbali i miratimit të dokumenteve të tenderit, bazohet në relacione teknike të një viti më parë që nuk ndodhen në dosjen e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Nuk ka hartuar procesverbalin për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

-Tek pjesa e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit janë kërkuar vetëm llojet e inxhinierëve pa përcaktuar përshkrimin e punës që do të kryejnë, për objektin që do prokurohet, për të zbatuar kontratën, referuar ligjit nr. 9643”Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007”Për rregullat e prokurimit publik”,i ndryshuar.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 74,907,945 lekë,

- Në procesverbalin e hapjes se ofertave ekonomike, mungon pjesëmarrja e saj në këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim me VKM nr 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale te AAC me fond limit 27,502,000 lekë.

- Në procesverbalin e mbajtur për hartimin e dokumenteve datë 2.03,2012, Njësia e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit i referohet relacioneve teknike, preventivit dhe projekteve përkatëse për llogaritjen dhe argumentimin e kufirit monetar për këtë procedurë prokurimi, të cilat janë prokuruar në tenderin e mëparshëm të zhvilluar në 2011,dhe argumentimi për përdorimin e kësaj procedure është mendimi i ardhur nga APP. Studimi që përcakton mënyrën e lëvrimit të këtij fondi, nuk ka detajet e duhura që mund të argumentojnë saktësisht nëpërmjet relacioneve teknike nevojën emergjente për shfrytëzimin e kësaj procedure, në kundërshtim me VKM nr1,datë 10.01.2007, i ndryshuar “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Mungon procesverbali mbi dorëzimin e dokumentacionit të fituesit, në kundërshtim me VKM nr 1,datë 10.01.2007, i ndryshuar.

2. z. ■■■■ me detyrë inspektor në Drejtorinë e Standardizimit Teknik pranë Autoritetit të Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit.

3. z. ■■■■ me detyrë inspektor në Drejtorinë e Kontrollit të Cilësisë dhe Menaxhimit të Cilësisë, Sektori i Kontrollit të Cilësisë, në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të njësisë së prokurimit, për arsye se:

-Nuk kanë kryer asnjë trajnim në APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika1/b, ku përcaktohet se ata duhet të kryejnë të paktën 1 trajnim në vit për çështjet e prokurimit publik;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Rikonstruksioni i godinës së Autoritetit të Aviacionit Civil Shqiptar me fond limit 50,000,000 lekë, mungojnë gjurmët e argumentimit të fondit limit dhe arsyetimi tek procesverbali i miratimit të dokumenteve të tenderit, bazohet në relacione teknike të një viti më parë që nuk ndodhen në dosjen e prokurimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, e ndryshuar;

- Tek pjesa e specifikimeve teknike të dokumenteve të tenderit janë kërkuar vetëm llojet e inxhinierëve pa përcaktuar përshkrimin e punës që do të kryejnë, për objektin që do prokurohet, për të zbatuar kontratën, referuar ligjit nr. 9643 ”Për prokurimin publik” i ndryshuar, neni 46 “Kualifikimi i ofertuesve, në kundërshtim me VKM nr1,datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar.

-Mungon procesverbali për dorëzimin e dokumenteve të operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 74,907,945 lekë:

-Në procesverbalin e hapjes së ofertave ekonomike, mungon pjesëmarrja e z.Olsion Allka në këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim me VKM nr. 1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”.

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 27,502,000 lekë:

-Në procesverbalin e mbajtur për hartimin e dokumenteve datë 2.03.2012, Njësia e hartimit të dokumenteve standarde të tenderit i referohet relacioneve teknike, preventivit dhe projekteve përkatëse për llogaritjen dhe argumentimin e kufirit monetar për këtë procedurë prokurimi, të cilat janë të prokuruar në tenderin e mëparshëm të zhvilluar në 2011, dhe argumentimi për përdorimin e kësaj procedure është mendimi i ardhur nga APP. Studimi që përcakton mënyrën e lëvrimit të këtij fondi nuk ka detajet e duhura që mund të argumentojnë saktësisht nëpërmjet relacioneve teknike nevojën emergjente për shfrytëzimin e kësaj procedure, në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar “Për rregullat e prokurimit publik”;

-Mungon procesverbali mbi dorëzimin e dokumentacionit të fituesit, në kundërshtim me VKM nr .1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

-Në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 74,907,945 lekë:

- Nuk ka kryer një përcaktim të detajuar të kërkesave të veçanta në dokumentet e tenderit, për inspektorët që do të kryejnë shërbimet e konsulencës sipas objektit të prokurimit, pjesa e specifikimeve teknike detyrat e inspektoreve por ka vetëm referime të rregulloreve sipas specifikimeve teknike, nuk përcaktohen qartë përkrahimi dhe detajimi i programeve për Vlerësimin e Sigurisë së Avionëve të Huaj [REDAKTUAR], por vetëm në vija të përgjithshme, në kundërshtim me VKM nr 1 ”Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Nuk ka kryer një studim të detajuar për përllogaritjen dhe caktimin e fondit limit për fillimin e procedurave të prokurimit “Për shërbimin e asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes së sigurisë ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC”, për vitin 2012, pasi çdo dokumentacion justifikues bazohet në relacione dhe në studime të vitit të mëparshëm, në kundërshtim me VKM nr1, datë 10.01.2007.

4. zj. [REDAKTUAR] me detyrë inspektore në Drejtorinë e Standardizimit Teknik në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit.

5. zj. [REDAKTUAR] me detyrë specialiste buxheti në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtares së njësies së prokurimit.

6. z. [REDAKTUAR] me detyrë specialist në Sektorin e përfaqësimit ligjor dhe prokurimeve në Autoritetin e Aviacionit Civil , në cilësinë e anëtarit të njësies së prokurimit, për arsye se:

-Nuk kanë kryer asnjë trajnim në APP, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” Kreu V “Zhvillimi i procedurave” pika1/b, ku përcaktohet se ata duhet të kryejnë të paktën 1 trajnim në vit për çështjet e prokurimit publik;

- Në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë, mungon llogaritja e çmimit të shitjes së dokumenteve të tenderit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë, në kundërshtim me nenin 49 të ligjit nr 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik, të ndryshuar dhe kreun III pika 2/e të VKM nr1 datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, nuk është bërë konfiskimi i sigurimit të ofertës i operatorit ekonomik “██████” sh.p.k, për tërheqje të njëanshme nga procedura e prokurimit. Vlera e sigurimit të ofertës është 299,600 lekë, që do thotë 2% e fondit limit;

-Në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë, në dokumentet e tenderit, pjesa e specifikimeve teknike, janë kërkuar standarde specifike të përcaktuara, sipas normave UNI EN ISO 9001-2008, të standardit ndërkombëtar të menaxhimit të cilësisë, të cilat do të garantonin cilësinë e mallrave dhe shërbimeve objekt i këtij prokurimi, por nuk janë shtuar ISO ekuivalente me standardet e tjera, duke përbërë shkak për kufizim të pjesëmarrjes në tender të sa me shumë operatorëve, në kundërshtim me ligjin nr. 9643 “Për prokurimin publik” datë 20.11.2006, i ndryshuar, nenit 23, pika 2 dhe 3.

- Në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë, nuk kanë hartuar procesverbalin e komisionit të vlerësimit të ofertave, për paraqitjen e dokumenteve ligjore nga fituesi, në kundërshtim me nenin 52 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

7. z. ██████ me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e Kryetarit të Vlerësimit të Ofertave

8. z. ██████ me detyrë Përgjegjës i sektorit të mbikëqyrjes së zbatimit të marrëveshjeve të shërbimit ajror dhe tregtar në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, për arsye se:

-Për vlerësim si të vlefshëm të operatorit ██████ gjatë hapjes së ofertave të procedurës së prokurimit “Rikonstruksioni i Godinës Autoriteti i Aviacionit Civil”, me fond limit 14 980 000 lekë, si rrjedhojë, tej zgjatje të procedurave, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Për mos nënshkrim të ofertës ekonomike fituese dhe preventivin e punimeve me zërat përkatës, në procedurën e prokurimit “Rikonstruksioni i Godinës Autoriteti i Aviacionit Civil” me fond limit 50,000,000 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

9. zj ██████ me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Standardizimit Teknik në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit “Rikonstruksioni i Godinës Autoriteti i Aviacionit Civil” fond limit 50,000,000 lekë dhe “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC ” me fond limit 27,502,000 lekë, për arsye se :

-Për vlerësim si të vlefshëm të operatorit ██████ gjatë hapjes së ofertave të procedurës së prokurimit “Rikonstruksioni i Godinës Autoriteti i Aviacionit Civil”, si rrjedhojë, tej zgjatje të

procedurave, në kundërshtim me VKM nr 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar;

-Për mosrespektim të parimit të konkurrencës në procedurën e prokurimit “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC”, për dërgimin e të paktën 5 ftesave për negocim operatorëve ekonomikë duke marrë parasysh specifikën e këtij prokurimi, në kundërshtim me nenin 1, pika c, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar.

10. ■■■■■ ish punonjëse në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit 1.“Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë; 2.“Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC” me fond limit 27,502,000 lekë;

-Për mosrespektim të parimit të konkurrencës në procedurën e prokurimit “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 27,502,000 lekë, për mos dërgimin e të paktën 5 ftesave për negocim operatorëve ekonomikë duke marrë parasysh specifikën e këtij prokurimi, në kundërshtim me nenin 1, pika c, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar;

-Nuk ka nënshkruar ofertën ekonomike të fituesit, në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” me fond limit 14 980 000 lekë, në kundërshtim me VKM nr1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

-Nuk ka nënshkruar procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të operatorit fitues, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

11 z ■■■■■ me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Cilësisë në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në procedurat e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së, me fond limit 14 980 000 lekë, për arsye se:

-Nuk ka nënshkruar ofertën ekonomike të fituesit, në procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së”, me fond limit 14 980 000 lekë, në kundërshtim me VKM nr1, datë 10.01.2007, i ndryshuar;

-Nuk ka nënshkruar procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të operatorit fitues, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së”, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

12 z ■■■■■ ish punonjës në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC”.

13 z ■■■■■ ish punonjës në Autoritetin e Aviacionit Civil, në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, në tenderin e zhvilluar me objekt “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC” për arsye se :

Në procedurën e prokurimit “Shërbimi i asistencës së huaj për funksionet e mbikëqyrjes ajrore dhe zhvillimin e kapaciteteve teknike dhe profesionale të AAC me fond limit 74,907,945 lekë:

-Nuk kanë nënshkruar ofertën ekonomike të fituesit në kundërshtim me VKM nr.1, datë 10.01.2007.

-Nuk kanë nënshkruar procesverbalin e dorëzimit të dokumenteve të operatorit fitues, për procedurën e prokurimit “Blerje pajisje dhe orendi për zyrat e AAC-së” në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar.

Shënim : Do rekomandonim masa disiplinore, për ish-Drejtorët Ekzekutiv, z. [REDAKTUAR], z. [REDAKTUAR]. dhe z. [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] ish-drejtori i drejtorisë së Sigurisë Ajrore dhe z. [REDAKTUAR] ish-drejtor i drejtorisë së Kontrollit të Shërbimit të Trafikut Ajror, [REDAKTUAR] z. [REDAKTUAR] specialistë në AAC, për mangësitë dhe shkeljet e konstatuara në Raportin Përfundimtar të Auditimit, por meqenëse këta person janë larguar nga detyra që kanë mbajtur për periudhën viti 2012-2013 në Autoritetin e Aviacionit Civil, masa disiplinore konsiderohet e ezauruar.

Në vijim do të njoftohet Drejtoria e Administratës Publike për personat e lartpërmendur.

Shënim: Auditimi i krye nga audituesit Yllka Pulashi, Luljeta Shtylla, Jorida Zhegumë tej u shqyrtua nga k/auditues Bashkim Arizaj, Drejtori i Departamentit Xhafer Xhorxhaj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë Ermal Yzeiraj, si dhe u verifikua si praktike nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT